

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar
Financial Reporting
(Planprogrami i ri)

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 25.07.2020

1. Në vijim janë draft pasqyrat e pozitës financiare të Columbus sh.a, Magellan sh.a and Vespucci sh.a me 31 dhjetor 2019:

	Columbus sh.a €'000	Magellan sh.a €'000	Vespucci sh.a €'000
Pasuritë			
Pasuritë jo-qarkulluese:			
Prona, fabrika dhe paisjet	968	600	360
Investimet në Vespucci sh.a	<u>79</u>	<u>-</u>	<u>-</u>
	1,047	600	360
Pasuritë qarkulluese	<u>447</u>	<u>312</u>	<u>276</u>
Total pasuritë	1,494	912	636
Ekuiteti dhe detyrimet			
Ekuiteti:			
Aksionet e zakonshme prej €0.50 secila	276	228	216
Premia e aksioneve	126	102	90
Fitimet e mbajtura	<u>174</u>	<u>(30)</u>	<u>72</u>
Total ekuiteti	576	300	378
Detyrimet:			
Detyrimet afatgjata	720	438	204
Detyrimet afatshkurtëra	<u>198</u>	<u>174</u>	<u>54</u>
Total detyrimet	<u>918</u>	<u>612</u>	<u>258</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	1,494	912	636

Informatat në vijim janë të rëndësishme:

- (i) Columbus sh.a bleu 60% të aksioneve të zakonshme të Magellan sh.a-së me 1 janar 2018 për një konsideratë prej €300,000 e pagueshme me 31 dhjetor 2020. Premia e aksioneve dhe fitimet e mbajtura në atë datë ishin €102,000 dhe €5,000. Vlerat e drejta të pasurive neto në datën e blerjes ishin të barabarta me vlerat e tyre bartëse përveç një zëri të fabrikës. Vlera e drejtë e fabrikës ishte më e lartë se vlera e saj bartëse për €10,000. Kishte një jetë ekonomike të përdorimit të mbetur prej 5 viteve në datën e blerjes. Korigjimet e vlerës së drejtë nuk janë inkorporuar në pasqyrat financiare më sipër.
- (ii) Columbus sh.a bleu 40% të aksioneve të zakonshme të Vespucci sh.a's me 31 dhjetor 2018 për një konsideratë prej €79,000. Premia e aksioneve dhe fitimet e mbajtura në atë datë ishin €90,000 dhe €32,000. Vlerat e drejta të pasurive neto në datën e blerjes ishin të barabarta me vlerat e tyre bartëse.
- (iii) Columbus sh.a ka një kosto të kapitalit prej 10%. Faktorët e skontimit janë si më poshtë:

Viti	FS @10%
1	0.909
2	0.826
3	0.751

- (iv) Gjatë vitit deri me 31 dhjetor 2019, Magellan sh.a shiti mallra tek Columbus sh.a për një shumë prej €18,000. Mallrat i kishin kushtuar Magellan sh.a-së €15,000 kur i kishte blerë. 20% prej këtyre mallrave janë ende në stoqe të Columbus sh.a.
- (v) Magellan sh.a dhe Vespucci sh.a nuk kanë emetuar aksione shtesë që nga koha kur janë blerë nga Columbus sh.a.
- (vi) Investimi në Vespucci sh.a është paraqitur në pasqyrën e pozitës financiare të Columbus sh.a-së sipas kostos. Investimi në Magellan sh.a nuk është përfshirë (regjistruar) në pasqyrat e Columbus sh.a-së.
- (vii) Zëri i mirë në Magellan sh.a është dëmtuar për €2,000 me 31 dhjetor 2019.
- (viii) Është politikë e grupit të vlerësoj interesat jo-kontrollues sipas vlerës së plotë (të drejtë). Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në Magellan sh.a me 1 janar 2018 ishte €150,000.

Kërkohet:

Përgatite pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të Columbus sh.a me 31 dhjetor 2019.

(20 pikë)

Grupi Columbus sh.a**€'000****Pasuritë***Pasuritë jo-qarkulluese:*

Prona, fabrika dhe paisjet (968+600+10-4L1) 1,574.00

Investimet në shoqëri L13 95.00

Zëri i mirë L1 28.30

1,697.30

Pasuritë qarkulluese (447+312-0.6 FPR) 758.40**Total pasuritë 2,455.70****Ekuiteti dhe detyrimet**

Ekuiteti:

Aksionet e zakonshme prej €0.50 secila 276.00

Premia e aksioneve 126.00

Fitimet e mbajtura L14 117.73

519.73

Interesat jo-kontrollues L15 133.36

Total ekuiteti 653.09

Detyrimet:

Detyrimet afatgjata (720+438 + 272.61L12) 1,430.61

Detyrimet afatshkurtëra (198+174) 372.00Total detyrimet 1,802.61**Total ekuiteti dhe detyrimet 2,455.70****L11 Zëri i mirë****€'000**

Magellan sh.a

Kosto e investimit 300 x 0.751 225.30

Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues 150.00

Vlera e drejtë e pasurive neto të blera:

Aksionet e zakonshme (228.00)

Premia e aksioneve (102.00)

Fitimet e mbajtura (5.00)

Korigjimi i vlerës së drejtë - fabrika (10.00)Vlera e drejtë e pasurive neto të blera (345.00)

Zëri i mirë 30.30

Minus: Dëmtimi (2.00)**28.30**

Zhvlerësimi shtesë në korigjimin e vlerës së drejtë (10 x 2/5 vite) = 4.00

FPR = 20% x (18 - 15) = 0.6

L12 Konsiderata e shtyrë

	€'000
Vlera e tanishme me 1 janar 2018 L11	225.30
Interesi për shkak të ç'skontimit (viti1)@10%	22.53
Interesi për shkak të ç'skontimit (viti2)@10% $(225.30+22.53) \times 10\%$	<u>24.78</u>
Vlera me 31 dhjetor 2019	272.61

L13 Investimet në shoqëri

	€'000
Kosto e investimit	79
Pjesa e fitimeve të mbajtura pas blerjes L14	<u>16</u>
	95

L1 4 Fitimet e mbajtura

	€'000
Columbus sh.a	174.00
Pjesa e fitimeve pas blerjes në:	
Magellan sh.a $60\% \times [(-30-5) - \{20\% \times (18 - 15)\}FPR-4L11]$	(23.76)
Vespucci sh.a $[40\% \times (72-32)]$ 16.00	
Dëmtimi i zërit të mirë në Magellan sh.a $(60\% \times 2)$	(1.20)
Interesi për shkak të ç'skontimit $(22.53+24.78)L12$	<u>(47.31)</u>
	117.73

L1 5 Interesat jo-kontrollues

	€'000
Magellan sh.a	
Vlera e drejtë në blerje	150.00
Pjesa pas blerjes e:	
Fitimeve të mbajtura $(40\% \times -39.6)$	(15.84)
Dëmtimit të zërit të mirë $(40\% \times 2)$	<u>(0.80)</u>
Total	133.36

2. Marco Polo sh.a është një kompani e listuar në bursë, e cila monton paisje elektrike të cilat më pas i shet tek klientët me shumicë dhe pakicë. Menaxhmenti i Marco Polo sh.a-së ishte i dëshpëruar me rezultatet e kompanisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. Si përpjekje për të përmirësuar performancën këto masa ishin marrë në fillim të vitit që përfundon me 31 dhjetor 2019:

- Një kampanjë e reklamimit në të gjithë vendin ishte ndërmarrë.
- Aplikimi i zbritjeve për të gjithë klientët me shumicë që blejnë mbi një nivel të caktuar.
- Montimi i disa linjave u ndërpre dhe u zëvendësua me mallra të përfunduara të blera nga jashtë. Kjo i mundësoi Marco Polo sh.a-së që të shesë njërën fabrikë që ishte e tepërt.

Pasqyrat e përmbledhura të Marco Polo sh.a-së për vitin e përfunduar 31 dhjetor 2019:

Pasqyra e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019	€m	
Të hyrat (25% shitje me para të gatshme)	4,000	
Kosto e shitjeve	<u>(3,450)</u>	
Fitimi bruto	550	
Shpenzimet operative	<u>(370)</u>	
Fitimi operativ	180	
Fitimi nga shitja e fabrikës (shënim (i))	40	
Kosto financiare	<u>(20)</u>	
Fitimi para tatimit	200	
Shpenzimet e tatimit në fitim	<u>(50)</u>	
Fitimi për vitin	150	
Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2019	€m	€m
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet (shënim (i))		550
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	250	
Të arkëtueshmet tregtare	360	
Banka	<u>-</u>	<u>610</u>
Total pasuritë		1,160
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>		
Aksionet e zakonshme (25 cent secila)		100
Fitimi i mbajtur		<u>380</u>
		480
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
8% notë krediti		200
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Mbitërheqja bankare	10	
Të pagueshmet tregtare	430	
Tatimi aktual i pagueshëm	<u>40</u>	<u>480</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet		1,160

Më poshtë janë llogaritur koeficientët për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018:

Kthimi në kapitalin e angazhuar	28.1%
Qarkullimi i pasurisë (shitjet/kapitali i angazhuar)	4 herë
Marzha e fitimit bruto	17%
Marzha e fitimit para interesit dhe tatimit	6.3%
Koeficienti i qarkullimit	1.6:1
Periudha e qarkullimit të stoqeve	46 ditë
Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme	45 ditë
Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme	55 ditë
Fitimi i dividendës	3.75%
Mbulimi i dividendës	2 herë

Shënime

- (i) Marco Polo sh.a pranoi €120m nga shitja e fabrikës e cila kishte shumë bartëse prej €80m në datën e shitjes së saj.
- (ii) Çmimi i tregut të aksioneve të Marco Polo sh.a-së përgjatë vitit ishte mesatarisht €3.75 për çdo aksion.
- (iii) Nuk ka pasur emetim apo riblerje të aksioneve apo kredive gjatë vitit.
- (iv) Dividendat e paguara gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2019 arritën shumën prej €90m, që ishte e njëjtë me dividendat e paguara në vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2018.

Kërkohet:

- (a) Llogariti koeficientët për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 (trego llogaritjet tuaja) për Marco Polo sh.a, ekuivalente me ato të dhëna më lartë. (10 pikë)
- (b) Analizo pozitën dhe performancën financiare të Marco Polo sh.a-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 duke e krahasuar me vitin paraprak. (10 pikë)

(Total: 20 pikë)

a) Llogaritja e koeficientëve

Kthimi në kapitalin e angazhuar (KNKA)

Fitimi para interesit dhe tatimit / Total pasuritë – detyrimet afatshkurtëra $(220/680 \times 100) = 32.3\%$

Qarkullimi i pasurisë

Shitjet / Kapitali i angazhuar $(4,000/680) = 5.9$ herë

Marzha e fitimit bruto

Fitimi bruto / Shitjet $(550/4,000 \times 100) = 13.8\%$

Marzha e fitimit para interesit dhe tatimit

Fitimi pas tatimit / Shitjet $(220/4,000 \times 100) = 5.5\%$

Koeficienti i qarkullimit

Pasuritë qarkulluese / Detyrimet afatshkurtëra $(610/480) = 1.27:1$

Periudha e qarkullimit të stogëve

Stoqet / Kosto e shitjeve $(250/3,450 \times 365) = 26$ ditë

Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme

Të arkëtueshmet tregtare / Shitjet $\times 365$ $(360/4,000 \times 365) = 33$ ditë

Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme

Të pagueshmet tregtare / Kosto e shitjeve $\times 365$ $(430/3,450 \times 365) = 45$ ditë

Fitimi i dividendës

Dividenda për aksion / Çmimi i tregut për aksion $\times 100$ $(0.225/3.75 \times 100) = 6\%$

*Dividenda për aksion

Dividenda e paguar / Nr. i aksioneve $(90/400) = 0.225$

Mbulimi i dividendës

Neto fitimi pas tatimit / Dividenda e paguar $(150/90) = 1.67$ herë

Ose Fitimet për aksion / Dividenda për aksion

b) Analiza krahasuese e përformancës dhe pozitës financiare të Marco Polo sh.a-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019.

Gjëja e parë që verëhet për rezultatet e Marco Polo sh.a-së është që KNKA është rritur për 4.2 pikë përqindje nga 28.1% to 32.3%. Kjo duket impresive. Megjithatë, ne duhet të marrim parasysh faktin se kapitali i angazhuar është zvogëluar për shkak të shitjes së fabrikës dhe fitimi neto është rritur nga fitimi i shitjes së fabrikës. Andaj KNKA është fryrë nga ky transaksion dhe ne duhet të shohim se sa do të kishte qenë KNKA pa ndodhur shitja. Duke e anashkaluar shitjen ne i kemi këtë koeficient:

$KNKA = 180 / (680 + 80) \times 100 = 23.7\%$

Qarkullimi i pasurive neto $= 4,000 / 760 = 5.3$ here

Marzha e fitimit para interesit dhe tatimit $= 180 / 4,000 \times 100 = 4.5\%$

Duke krahasuar këta koeficientë me ato të periudhës së përfunduar me 31 dhjetor 2018 mund të shohim se KNKA ka rënë. Kjo rënie është shkaktuar nga rënia në marzhën e fitimit para interesit dhe tatimit. Qarkullimi i pasurive është përmirësuar kur të shtojmë përsëri shitjen e pasurisë. Marzha e fitimit para interesit dhe tatimit mund të analizohet në dy faktorë – marzha e fitimit bruto dhe niveli i shpenzimeve. Përqindja e fitimit bruto është 3.2 % pikë përqindje më e ulët se sa në vitin e kaluar. Kjo mesiguri është për shkak të zbritjeve për klientët me shumicë, gjë që ka rritur shitjet por ka zvogëluar profitabilitetin. Zëvendësimi i disa linjave të prodhimit me produkte të blera mesiguri se ka zvogëluar marzhat e fitimit. Shitjet mund të jenë rritur për shkak të kampanjës së reklamave, por kjo ka shkaktuar shpenzime shtesë të cilat kanë ngarkuar fitimin para interesit dhe tatimit. Duket se menaxhmenti ka kërkuar të rrisë shitjet në çfardo mënyre. Shitja e fabrikës ka shërbyer për të maskuar efektin në fitim.

Likuiditeti i Marco Polo sh.a-së gjithashtu ka rënë në vitin e fundit. Koeficienti qarkullues ka rënë nga 1.6 në 1.3. Megjithatë, ka pasur gjithashtu edhe një rënie në periudhën e qarkullimit të stoqeve, mesiguri për shkak të mbajtjes së sasisë më të pakët të lëndës së parë për prodhim. Mund të jetë që mallrat e përfunduara mund të dërgohen direkt të shiteshi më shumicë nga furnitori. Kjo do të mund të ketë shërbyer në zvogëlimin e koeficientit qarkullues. Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme është shkurtuar për 12 ditë por edhe periudha e pagesës së llogarive të pagueshme është shkurtuar për 10 ditë. Duket se, si kthim për dërgimin me kohë, furnitori i mallrave të përfunduara kërkon pagesë të menjëhershme. Rënia në periudhën e pagesës së llogarive të pagueshme do të ketë shërbyer në përmirësimin e koeficientit qarkullues. Në nuk kemi detaje të saldosh së parasë së gatshme në vitin e kaluar, por Marco Polo aktualisht nuk ka para në bankë dhe ka një mbitërheqje bankare prej €10. Pa €120m nga shitja e fabrikës gjendja e likuiditetit do të kishte qenë shumë më keq.

Fitimi nga dividenda është rritur nga 3.75% në 6 %, që është mirë kur është fjala për investitorët potencial. Ne na është thënë që shuma e dividendës është e njëjtë me vitin e kaluar. Pasi që nuk ka pasur emetim të aksioneve, kjo nënkupton që dividenda për aksion është e njëjtë me vitin e kaluar. Andaj rritja në fitimin nga dividenda mund të ketë ardhur vetëm nga një rënie në çmimin e aksioneve. Tregu nuk është i impresionuar nga rezultatet e Marco Polo sh.a-së. Në të njëjtën kohë mbulimi i dividendës ka rënë. Dividenda e njëjtë është paguar nga më pak fitim (mbulimi i dividendës në vitin e kaluar ishte 2.0, pra fitimi duhet të ketë qenë €180m). Menaxhmenti ka vendosur se është më rëndësi të mirëmbahet dividenda, por kjo nuk ishte e mjaftueshme për të mbajtur lartë çmimin e aksioneve.

Si përfundim, mund të themi se pozita dhe performanca financiare e Marco Polo sh.a-së është përkeqësuar nga vitet e kaluar dhe çfarëdo përmirësimi është për shkak të shitjes së fabrikës.

3. Ju jeni kontabilist financiar i Pizarro sh.a dhe drejtori financiar ka kërkuar të përgatitni pasqyrën e rrjedhës së parasë duke përdorur metodën indirekte sipas SNK 7 *Pasqyra rrjedhës së parasë së gatshme*. Pasqyrat e përmbledhura të pozitës financiare me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë:

	2019 €'000	2018 €'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	4,625	3,685
Kostot e zhvillimit	<u>1,450</u>	<u>800</u>
	6,075	4,485
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	1,800	1,135
Të arkëtueshmet tregtare	1,370	1,620
Investimet	715	230
Paraja	<u>145</u>	<u>585</u>
	<u>4,030</u>	<u>3,570</u>
Total pasuritë	10,105	8,055
<i>Ekuiteti</i>		
Kapitali aksionar – €1 aksione të zakonshme	2,500	2,000
Premia e aksioneve	1,750	500
Teprica e rivlerësimit	800	300
Fitimet e mbajtura	<u>1,145</u>	<u>1,275</u>
	6,195	4,075
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
6% obligacione	750	500
Detyrimet ndaj lizingut	500	400
Tatimi i shtyrë	<u>240</u>	<u>225</u>
	1,490	1,125
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Të pagueshmet tregtare	1,370	1,760
Detyrimet ndaj lizingut	85	60
Tatimi aktual	280	765
Interesi në obligacion	25	-
Mbitërheqja bankare	<u>660</u>	<u>270</u>
	<u>2,420</u>	<u>2,855</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	10,105	8,055

Drejtori financiar ju ka dhënë këto informata të rëndësishme për të ju ndihmuar në përgatitjen e pasqyrës së rrjedhës së parasë.

- (i) Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, dividendat e paguara për aksionet e zakonshme ishin €1,030,000, shpenzimi i tatimit në fitim ishte €810,000 dhe kosto e financimit ishte €75,000.
- (ii) Gjatë vitit 2019 një paisjeve me shumë bartëse prej €515,000 u shit për €550,000. Fitimi ose humbja në shitje u përfshi në shpenzimet operative. Zhvlerësimi i ngarkuar gjatë vitit për pronat, fabrikat dhe paisjet ishte €285,000 dhe u ngarkua tek shpenzimet operative. Pizarro sh.a bleu pronë me vlerë të drejtë prej €280,000 nëpërmjet një lizingu financiar, pagesat bëhën në ditën e fundit të secilit vit financiar.
- (iii) Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, amortizimi në shumë prej €300,000 i kostove të zhvillimit është ngarkuar tek shpenzimet operative.
- (iv) Investimet në pasuritë qarkulluese janë investime në obligacione afatshkurtëra dhe shumë likuide të qeverisë dhe menaxhmenti ka vendosur t'i trajtoj si ekuivalent të parasë.
- (v) Gjatë vitit 2019 Pizarro sh.a bëri një emetim bonus prej 1 për 8 aksione dhe emetimi është financiar nga premia e aksioneve. Pjesa tjetër e aksioneve u emetua me një emetim të të drejtave.
- (vi) Obligacionet e reja u emetuan me 1 janar 2019. Kosto financiare përfshinë interesin në obligacione dhe ngarkesat financiare të lizingut financiar.

Kërkohet:

Përgatite pasqyrën e rrjedhës së parasë të Pizarro sh.a-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 duke përdorur metodën indirekte sipas SNK 7 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme.

(20 pikë)

3. Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme të Pizarro sh.a

	€' 000	€' 000
<i><u>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet operative</u></i>		
Fitimi para tatimit 900 L14 +810	1,710	
Kosto financiare	75	
Zhvlerësimi	285	
Amortizimi	300	
Fitimi nga shitja 550-515	<u>(35)</u>	
Rrjedhat e parasë para ndryshimeve në kapitalin qarkullues	2,335	
Rritja në stoqe 1,135-1,800	<u>(665)</u>	
Zvogëlimi në të arkëtueshme 1,620-1,370	250	
Zvogëlimi në të pagueshme 1,760-1,370	<u>(390)</u>	
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative	1,530	
Kosto financiare e paguar L17	<u>(50)</u>	
Tatimi i paguar L16	<u>(1,280)</u>	
Neto paraaja nga aktivitetet operative		200
<i><u>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet investuese</u></i>		
Paraja nga shitja e P.F.P	550	
Paraja e paguar për të blerë P.F.P L11	<u>(960)</u>	
Paraja e paguar për kostot e zhvillimit L12	<u>(950)</u>	
Neto paraaja nga aktivitetet investuese		(1,360)
<i><u>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese</u></i>		
Emetimi i aksioneve L13	1,750	
Rritja e borxhit afatgjatë 750-500	250	
Detyrimi ndaj lizingut i paguar L15	<u>(155)</u>	
Dividenda e paguar L14	<u>(1,030)</u>	
Neto paraaja nga aktivitetet financuese		815
Neto zvogëlimi në paranë dhe ekuivalentët e parasë		<u>(345)</u>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë 2018: 585+230-270		<u>545</u>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë 2019		200

Llogaritjet

L1 1: Prona, fabrika dhe paisjet	€'000
S/ fillim	3,685
Teprica e rivlerësimit	500
Lizingu financiar: P.F.P	280
Minus shitjet: P.F.P	<u>(515)</u>
Minus zhvl. vjetor	<u>(285)</u>
Paraja e paguar (shifër balancuese)	<u>960</u>
S/ fund	4,625

Ll 2: Kostot e zhvillimit	€'000
S/ fillim	800
Amortizimi	(300)
Paraja e paguar (shifër balancuese)	<u>950</u>
S/ fund	1,450
Ll 3: Emetimi i aksioneve	€'000
S/ fillim 2,000+500	2,500
Emetimi bonus 250-250	-
Paraja e pranuar (shifër balancuese)	<u>1,750</u>
S/ fund 2,500+1,750	4,250
Ll 4: Fitimet e mbajtura	€'000
S/ fillim	1,275
Fitimi për vitin	900
Dividendat e paguara (shifër balancuese)	<u>(1,030)</u>
S/ fund	1,145
Ll 5: Lizingjet financiare	€'000
S/ fillim 400+60	460
P.F.P nën lizing	280
Paraja e paguar (shifër balancuese)	<u>(155)</u>
S/ fund 500+85	585
Ll 6: Tatimet	€'000
S/ fillim 225+765	990
Ttmet	810
Paraja e paguar (shifër balancuese)	<u>(1,280)</u>
S/ fund 240+280	520
Ll7: Interesi/kosto financiare	€'000
S/ fillim	-
Kosto financiare	75
Paraja e paguar (shifër balancuese)	<u>(50)</u>
S/ fund	25

4.

a) Sipas *Kornizës Konceptuale* të IASB-së (BSNK-së), koncepti i ruajtje së kapitalit ka të bëjë me atë se si një entitet e definon kapitalin të cilin kërkon ta ruaj. Koncepti i kapitalit dallon ruajtjen e kapitalit financiar dhe ruajtjen e kapitalit fizik. Zgjedhja e konceptit të përshtatshëm të kapitalit nga një entitet duhet të bazohet në nevojat e përdoruesve të pasqyrave financiare.

Kërkohet:

Tregoni dallimi ndërmjet konceptit financiar dhe konceptit fizik të kapitalit. (6 pikë)

b) Pasi që një entitet ka njohur një zë të pronës, fabrikës dhe paisjes në librat e tij, entiteti mund të zgjedh ndërmjet dy modeleve (ose metodave) për të kontabilizuar pasurinë në periudhat pasuese të matjes, që do të thotë, periudhat pasi që pasuria është blerë dhe para largimit të saj. Dy modelet janë modeli i koston dhe i rivlerësimit. Entiteti duhet të aplikoj modelin e njejtë në tërë klasën e pronës, fabrikës dhe paisjeve.

Kërkohet:

Identifiko DY dallime ndërmjet modelit të koston dhe modelit të rivlerësimit për pronën, fabrikën dhe paisjen. (4 pikë)

c) Livingstone sh.a prodhon rezervuar të plastikës për industrinë e agrikulturës. Me 31 dhjetor 2019, stoqet në fund përbëheshin nga 250 njësi të përfunduara (rezervuar të plastikës). Informatat tjera janë si në vijim:

Secilit rezervuar i duhet 10 kg të plastikës për tu prodhuar, dhe secila njësi shkakton kosto të konvertimit (punë dhe shpenzime të përgjithshme) prej €25. Çmimi i blerjes së plastikës ishte €3 për kg gjatë tërë vitit deri me 31 dhjetor 2019, plus një shtesë prej €0.50 për kg të koston së dërgimit. Livingstone sh.a e shet një rezervuar për €100. Pritet që ky çmim do të bie në €90 si rezultat i rënies së çmimit të tregut të plastikës. Të gjitha njësitë e përfunduara të shitura nga Livingstone sh.a shkaktojnë një kosto prej €6 për shitje dhe shpërndarje.

Kërkohet:

Llogarite vlerën e stoqeve në fund në librat e Livingstone sh.a me 31 dhjetor 2019 duke aplikuar parimet e SNK 2 Stoqet. (5 pikë)

d) Një kompani ka këto zëra dhe transaksione.

- i) Fotografi të themeluesve të kompanisë, të cilat kanë vlerë shumë të madhe sentimentale dhe historike.
- ii) Donacion prej €10,000 të pranuar nga një filantropist.
- iii) Fabrikë të vjetër që tani është nxjerrur jashtë përdorimit.

Kërkohet:

Shpjego se si kompania duhet t'i kontabilizoj zërat e mësipërm, justifiko përgjigjet tuaja duke iu referuar definicioneve dhe kritereve të njohjes në *Kornizën Konceptuale* të IASB-së (BSNK-së) për raportim financiar. (5 pikë)

(Total: 20 pikë)

4.

a) Ruajtja e kapitalit financiar: Sipas këtij koncepti, fitimi krijohet vetëm nëse shuma financiare (ose shuma) e neto pasurive në fund të periudhës tejkalon shumën financiare (ose paranë) e neto pasurive në fillim të periudhës, pas përjashtimit të çfardo shperndarje tek dhe kontribute nga pronarët gjatë periudhës. Ruajtja e kapitalit financiar matet ose në njësi monetare nominale ose në njësi të fuqise blerese të kufizuar.

Ruajtja e kapitalit fizik: Sipas këtij koncepti, fitimi krijohet vetëm nëse kapaciteti fizik prodhues (ose aftësia operuese) e entitetit (ose burimet ose fondet e nevojshme për të arritur atë kapacitet) në fund të periudhës tejkalon kapacitetin fizik prodhues në fillim të periudhës, pas përjashtimit të çfardo shperndarje tek dhe kontribute nga pronarët gjatë periudhës.

b) Modeli i koston Vs Modeli i rivlerësimit

- Sipas SNK 16 *Prona, fabrika dhe paisjet* të gjitha blerjet në fillim njihen sipas koston, pas kësaj një entitet mund të zgjedh të aplikoj modelin e koston ku PFP bartet sipas koston minus zhvlerësimi i akumuluar, ose modelin e rivlerësimit, ku një zë i PFP bartet sipas shumës së ri-vlerësuar.
- Nëse modeli i rivlerësimit përdoret atëherë tërë klasa e pasurive të PFP të cilës pasuria i takon duhet të rivlerësohet. Shpeshtësia e rivlerësimit varet nga lëvizjet në vlerën e drejtë të zërave që po rivlerësohen, por kur ka lëvizje të mëdha në vlerën e drejtë, vlerësimet vjetore mund të kërkohen.
- Modeli i koston është më objektiv pasi që kosto është definitive, por jep informatë që është e vjetër. Modeli i rivlerësimit mund të konsiderohet më shumë subjektiv pasi që mbështetet në ekspertët e vlerësimit për të dhënë matje të besueshme të vlerës së drejtë. Matjet do të jenë më të reja në kohë, por mund të shpien në humbje apo përfitime të mëdha të rivlerësimit në rast të një rritje të madhe në tregun e pronave që pasohet nga një krizë në atë treg. Modeli i koston do të jetë më i lirë për tu aplikuar pasi që nuk kërkohen opinionet e ekspertëve.
- Lejimi i dy modeleve shpie në më pak krahasueshmëri ndërmjet entiteteve raportuese, jo vetëm në pasqyrën e pozitës fianciare por edhe të të ardhurave pasi që ngarkesat e zhvlerësimit do të korrigjohen për rivlerësim.

c) Stoqet e Livingstone sh.a duhet të vlerësohen si në vijim:

Mallrat e përfunduara:

Kosto për njësi:	€
Materiali – 10kg x €3	30
Konvertimi	<u>25</u>
Total	55

Vlera neto e realizueshme:

Çmimi i prituri i shitjeve	90
Minus kosto e vlerësuar e shitjes	<u>(6)</u>
Vlera neto e realizueshme	84

Pasi që vlera neto e realizueshme e tejkalon koston, mallrat e përfunduara vlerësohen në libra sipas kostos. Andaj vlera prej $250 \times €55 = €13,750$ do të paraqitet në pasqyra si stoqe në fund.

d)

i) *Fotografi të themeluesve të kompanisë, të cilat kanë vlerë shumë të madhe sentimentale dhe historike.*

Definicioni i pasurisë nuk përmbushet pasi që fotografitw nuk paraqesin pwrfitime tw ardhshme ekonomike. Përfitimet e ardhshme ekonomike përbëjnë potencialin për të kontribuar direkt ose indirekt, në rrjedhat e parasë dhe ekuivalentëve të parsë të një entiteti.

Kriteret e njohjës nuk janë të rëndësishem, pasi që nuk ka pasuri që duhet të njihet.

ii) *Donacion prej €10,000.*

Definicioni i pasurisë përmbushet kur janë prezente të gjitha 3 karakteristikat.

- Ngjarje e kaluar: Pranimi i donacionit.
- Rrjedha e përfitimeve të ardhshme ekonomike: Donacioni paraqet një hyrje prej €10,000 në para.
- Kontrolli: Kompania do të përfitoj nga këto €10, 000 rrjedha hyrëse dhe mund të i përdor këto fonde.

Andaj, një pasuri prej €10 000 duhet të njihet.

Definicioni i të ardhurave përmbushet kur të 3 karakterisrikat janë prezente.

- Rritja në përfitimet ekonomike gjatë periudhës:
- Në formen e rritjes së pasurive: Kompania tani ka €10,000 më shumë.
- Rezulton në një rritje të ekuitetit: Nëse pasuritë rriten ndërsa detyrimet mbesin të njejta, ekuiteti rritet.

Andaje, të ardhurat prej €10,000 duhet të njhen gjithashtu. Në këtë rast njohja e një pasurie ka rezultuar me njohjen e njëkohsme të një të ardhure.

iii) *Fabrikë e vjetër që tani është nxjerrur jashtë përdorimit.*

Definicioni i pasurisë nuk përmbushet pasi që fabrika nuk paraqet më përfitime të ardhshme ekonomike. Fabrika tani duhet të shlyhet nga llogaritë. Kriteret e njohjës nuk janë të rëndësishem, pasi që nuk ka pasuri që duhet të njihet.

5.

a) SNRF 15 Të hyrat nga kontratat me klientët është publikuar në maj 2014, dhe hyn në fuqi për periudhat që fillojnë me apo pas 1 janarit 2018. Megjithatë, adoptimi i mëhershëm është i lejuar.

- (i) Me 31 dhjetor 2019, Cabral sh.a nënshkroi një kontratë për të furnizuar 500 njësi të një produkti për një çmim prej €1,000 për njësi. 300 njësi janë dërguar në po atë datë, dhe të tjerat do të dërgohen me 1 mars 2020. U dakordua që klienti do të bëjë pagesën 12 muaj pas datës së dërgesës së njësive të produktit. Kosto e kapitalit të Cabral sh.a është 10%.

(4 pikë)

- (ii) Gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2019, Cabral sh.a morri një pagesë në avans për dhenien e 2,000 orëve të shërbimeve me një çmim prej €100 për orë. Vetëm 400 prej orëve të shërbimeve ishin shfrytëzuar deri me 31 dhjetor 2019. Shumat e paguara nga klienti janë të pakthyeshme përveç nëse kompania dështon të sigurojë shërbimin e premtuar.

(4 pikë)

Kërkohet:

Në secilin skenar mësipër, llogarite shumën e të hyrave që duhet të njihet në pasqyrat financiare të Cabral sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019. Trego hyrjet në ditar për të regjistruar secilin transaksion. Arsyeto përgjigjen tuaj në secilin rast.

(Total 8 pikë)

b) SNRF 16 Lizingjet është publikuar në janar 2016 dhe hyn në fuqi për periudhat që fillojnë me apo pas 1 janarit 2019. Megjithatë, adoptimi i mëhershëm është i lejuar.

- (i) Me 1 janar 2019, Elcano sh.a hyri në një marrëveshje për të marrë në lizing një ndërtesë për një periudhë 10 vjeçare. Kushtet e lizingut të përcaktuara janë që të bëhen pagesa vjetore prej €100,000 në vit në fund të vitit, dhe pagesa e parë duhet të paguhet me 31 dhjetor 2019. Norma e nënkuptueshme në lizing është 7%, dhe vlera e tanishme e pagesave minimale të lizingut është €702,358. Elcano sh.a kishte edhe një kosto prej €30,000 për të hyre në këtë kontratë të lizingut. Sipas kushteve të kontratës së lizingut afati mund të shtyhet sipas kushteve (pagesave) që do të mbizotërojnë në treg. Megjithatë nuk është e sigurtë nëse Elcano sh.a do ta ushtrojë këtë opcion.

(6 pikë)

- (ii) Në po të njejtën datë, Elcano sh.a hyri në një marrëveshje për të blerë një paisje motorike. Kushtet e marrëveshjes ishin që paisja do të merrej me lizing për 5 vite nga data e fillimit, për një pagesë fillestare prej €19,972 dhe 5 pagesa të tjera vjetore prej €6,500 të paguara në avans (fillim të vitit) duke filluar nga data 1 janar 2019. Vlera e drejtë e paisjes dhe vlera e tanishme e të gjitha pagesave përfshirë edhe pagesën fillestare të lizingut ishte €48,000 në fillim të lizingut. Norma e nënkuptuar në lizing është 8%.

(6 pikë)

Kërkohet:

Trego, me llogaritjet e duhura, hyrjet në kontabilitet për të regjistruar secilin transaksion mësipër për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019. Paraqiti ekstraktet përkatëse nga pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, dhe pasqyrën e pozitës financiare në po atë datë.

(Total: 12 pikë)

5. a)

(i) Kontrata për furnizim nuk është e mjaftueshme për t'i njohur të hyrat. Është e domosdoshme që kontrolli i mallrave të këtë kaluar tek klienti. Ky është rasti për 300 njsitë. Pagesa e shtyrë nuk e ndalon njohjen e të hyrave, por konsiderata duhet të matet sipas vlerës së drejtë në datën e transaksionit të shumës së arkëtueshme. Vlera e drejtë duhet të reflektoj një skontim për vlerën në kohë të parasë, si rezultat i pagesës me afat. Norma e skontimit do të jetë 10% që është kosto e kapitalit të Cabral sh.a-së. Andaj të hyrat do të njihen si në vijim: $300 \text{ njsi} \times €1,000 \times 1/1.10 = €272,727$.

Skontimi do të njihet si e hyrë financiare me kalimin e kohës, sipas bazës kohore. Pasi që shitja ka ndodhur me 31 dhjetor 2019, nuk ka kaluar asnjë pjesë e kohës që të shkaktoj njohjen e të hyrave financiare.

Hyrjet në ditar:

	€	€
D Të arkëtueshmet tregtare	272,727	
K Të hyrat		272,727

(Njohja e të hyrave dhe të arkëtueshmeve tregtare sipas vlerës së drejtë të konsideratës së pranuar)

(ii) Përsëri, parimet e njehta aplikohen. Të hyrat njihen kur kontrolli i mallrave dhe shërbimeve transferohen tek klienti. Këtu, paraja është pranuar në avans. Megjithatë të hyrat njihen vetëm kur shërbimi të kryhet. Çdo shumë e tepërt e parasë e mbajtur njihet si një e hyrë e shtyrë, një detyrim. Nëse paraja është e pakthyeshme kjo nuk e ndryshon kohen e njohjes së të hyrave. Megjithatë, nëse e drejta e klientit për të kërkuar shërbimet skadon, dhe klienti nuk ka të drejtë të kërtoj kthimin e parave atëhere të hyrat duhet të njihen.

Total paraja e pranuar në vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019: $2000 \times €100 = €200,000$

Total orët e shërbimit të dhënë 400

Të hyrat e njohura = $400 \times €100 = €40,000$

Të hyrat e shtyera = $200,000 - 40,000 = 160,000$

Hyrjet në ditar:

	€ 000	€ 000
D Paraja	200	
K Të hyrat		40
K Të hyrat e shtyera		160

(njohja e të hyrave, të hyrave të shtyera dhe parasë së pranuar)

b)

(i)

Njohja fillestare & matja:

Detyrimi ndaj lizingut në fillim regjistrohet për €702,358.

Pasuria njihet me këtë shumë plus kosto ($€702,358 + 30,000$), ose €732,358.

Hyrjet në ditar:

D Ndërtesa nën lizing	€732,358	
K Detyrimi ndaj lizingut		€702,358
K Paraja (kosto)		€30,000

Matja pasuese:

Kosto financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 ($702,358 \times 7\%$)	€49,165
Pagesa e bërë me 31 dhjetor 2019	€100,000
Zhvlerësimi i pasurisë nën lizing ($732,358 / 10$ vite)	€73,236

Hyrjet në ditar:

D Fitimi ose humbja (kosto financiare)	€49,165
K Detyrimi ndaj lizingut	€49,165
D Detyrimi ndaj lizingut	€100,000
K Paraja	€100,000
D Fitimi ose humbja (zhvlerësimi)	€73,236
K Zhvlerësimi i akumuluar i pasurisë nën lizing	€73,236
Saldo në fund e detyrimit ndaj lizingut ($702,358 + 49,165 - 100,000$)	€651,523
Prezantuar si detyrim afatshkurtë ($100,000 - (651,523 \times 7\%)$)	€54,393
Prezantuar si detyrim afatgjatë	€597,130

Ekstraktet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019:

Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019:	€
Shpenzimet operative (zhvlerësimi)	73,236
Kosto financiare	49,165

Pasqyra e pozitës financiare 31 dhjetor 2019:	€
Pasuritë jo-qarkulluese:	
Ndërtesa me lizing ($732,358 - 73,236$)	659,122
Detyrimet afatgjata:	
Detyrimi ndaj lizingut	597,130
Detyrimet afatshkurtera:	
Detyrimi ndaj lizingut	54,393

(ii)

Njohja fillestare & matja:

Pasuria njihet për: €48,000	
Detyrimi ndaj lizingut në fillim njihet për ($€48,000 - 19,972 - 6,500$)	€21,528

Hyrjet në ditar:

D Paisjet	€48,000
K Detyrimi ndaj lizingut	€21,528
K Paraja (pagesat në avans: $19,972 + 6,500$)	€26,472

Matja pasuese:

Kosto financiare për vitin e përfunduar me dhjetor 2019 ($21,528 \times 8\%$)	€1,722
Zhvlerësimi i pasurisë nën lizing ($48,000 / 5$ vite)	€9,600

Hyrjet në ditar:

D Fitimi ose humbja (kosto financiare)	€1,722
K Detyrimi ndaj lizingut	€1,722

D Fitimi ose humbja (zhvlerësimi)	€9,600	
K Zhvlerësimi i akumuluar i pasurisë nën lizing		€9,600
Saldo në fund e detyrimit ndaj lizingut (21,528 + 1,722)		€23,250
Prezantuar si detyrim afatshkurtë (pagesa e plotë në avans që duhet të bëhet me 1 janar 2020)		€6,500
Prezantuar si detyrim afatgjatë		€16,750
Ekstraktet e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019:		
Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019:		€
Shpenzimet operative (zhvlerësimi)		9,600
Kosto financiare		1,722
Pasqyra e pozitës financiare 31 dhjetor 2019:		€
Pasuritë jo-qarkulluese:		
Ndërtesa nën lizing (48,000 - 9,600)		38,400
Detyrimet afatgjata:		
Detyrimi ndaj lizingut		16,750
Detyrimet afatgjata:		
Detyrimi ndaj lizingut		6,500